



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Qershor 2018

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujo

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2018

© Ministria e Financave, 2018

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [vivi.besho@financa.gov.al](mailto:vivi.besho@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2018 arriti në 104.8 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Qershor 2018 ishte 2.4 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Qershor 2018 ishte 107.77 lekë për dollarë dhe 125.95 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Qershor 2018 shënuan kuotën 0.79 për qind për ato 12 –mujore; 0.67 për qind për depozitat 6-mujore; 0.29 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.72 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.22 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.33 për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,230.072 milionë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rënie prej rreth 0.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të 2018-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 142.4 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Qershor 2018 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 1.6 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar 2.8 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, arritën në rreth 217,035 miliardë lekë ose afërsisht 97% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 215,336 miliardë lekë ose 95% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

# Zhvillimet Ekonomike


## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Qershor 2018 ishte +2.4%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.2%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Qershor 2018 shënoi rënie prej 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës, ndërsa në muajin maj pati rënie prej 1.2 për qind. Përgjatë muajit Prill 2018, indeksi ka shënuar rënie prej 0.5 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2017 shënoi rënie 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Argëtim dhe kulturë” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.2%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje; “Veshje dhe këpucë” me një rritje vjetore të çmimit prej +3.3%, duke kontribuar me +0.12 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.4%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria e



“Shëndetit”, ka ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit qershor 2018.

**Ndryshimi mujor i indeksit është -0.1%.** Krahasuar me muajin Maj 2018 ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shëndeti” me 0,5%, pasuar nga “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0.3%. Ndërsa, çmimet e grupit “Transporti” shënuan një rritje prej 0,6 %, pasuar nga grupet “ Veshje dhe këpucë” me 0,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,1 %.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2017</b>	2.8	2.2	2.1	1.9	2.0	2.2	2.0	1.6	1.6	1.9	1.7	1.8
<b>2018</b>	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	<b>2.4</b>						


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Qershor 2018, arriti në 125.95 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.81 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor, një euro u këmbye me 125.93 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2018 arriti në 107.77 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.33 për qind kundrejt muajit maj 2018. Në fund të muajit Qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 108.13 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 5.45 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 9.12 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.86 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Qershor 2018, normat e interesit të depozitave me afat 12 mujor shënuan vlerën më të lartë prej 0.79 për qind, pasuar nga ato me afat 1 dhe 6-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.72 dhe 0.67 për qind. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore arritën kuotën 0.29 për qind.


Normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore kanë shënuar rritje mujore me 0.04 dhe 0.11 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 3 dhe 1-mujore kanë pësuar rritje prej përkatësisht 0.02 dhe 0.08 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 3-mujore, kanë pësuar rritje me 0.02 dhe 0.01 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 6 dhe 1-mujore kanë shënuar rënie përkatësisht me 0.13 dhe 0.24 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit Qershor 2018 arritën përkatësisht kuotën prej 8.33 dhe 5.22 për qind. Normat e interesit të huave 12-mujore kanë shënuar rënie mujore prej 0.64, ndërsa huatë 6-mujore kanë shënuar rritje prej 1.78 për qind. Ndërsa krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12-mujore kanë shënuar rënie prej 2.22 dhe 1.14 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Qershor 2018 arritën nivelin 2.07 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.19 për qind dhe rritje vjetore prej 0.03 për qind.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot


Burimi: Banka e Shqipërisë

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2018 shënoi rënie të mjeteve valutore, me rreth 142.4 milionë euro. Tremujori i parë i 2018-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 165 milionë euro, dhe vlerësohet në zgjerim me bazë vjetore (rreth 11%). Deficiti tregtar u zgjerua me rreth 14%, në nivelin 355 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 146 milionë euro në rritje me 22 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto pozitiv prej rreth 164.1 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2.443 milionë euro dhe janë zgjeruar me 9% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 165 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 11%. Thellimi i deficitit korrent u diktua nga zgjerimi i deficitit tregtar (mallra) -shpenzime të larta të importeve në makineri- pajisje dhe lëndëve djegëse e energjisë. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e katërt 2018 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -614.5 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 259.7 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 11.2 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 201.4 milionë euro.



**Bilanci i Pagesave per T1 - 2018**

Burimi: Banka e Shqipërisë



**Llogaria Korente per T1 - 2018**

Burimi: Banka e Shqipërisë





## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2018, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 1.673 milionë lekë krahasuar me muajin Qershor të vitit 2017. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1.748 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 11.230 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 24.710 milionë lekë të bankës qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.230.072 milionë lekë në muajin Qershor 2018, duke shënuar rënie prej rreth 9.095 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rënie vjetore prej 0.7 për qind.

Në muajin Qershor 2018, sistemi bankar rezulton me rritje prej 7.062 milionë lekë ose 0.6 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2018 arriti në rreth 530.192 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 13.304 milionë lekë, ose rënie prej rreth 2.45 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në lekë, duke përbërë rreth 50.1 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 265.842 milionë lekë.

Gjatë muajit Qershor 2018, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 60.5 për qind ose 320.863 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.04 për qind ose 180.455 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.69 dhe 1.61 për qind apo 19.584 dhe 8.552 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Qershor 2018, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 72.2 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 25.1 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me rreth 1.69 për qind dhe rreth 0.96 për qind.



## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 256.783 milionë lekë në fund të muajit Qershor 2018. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Qershor 2018 ka shënuar rritje mujore prej 0.05 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.66 për qind, duke arritur nivelin 20.9 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.08 për qind dhe rritje vjetore prej 1.04 për qind, duke shënuar nivelin 26.4 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Qershor 2018, kanë pësuar rënie prej 1.340 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.4 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Qershor 2018 shënuan rënie prej 14.107 milionë lekë në krahasim me muajin Qershor 2017. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 83.2 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2018, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 83.2 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.5 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.3 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.4 për qind dhe rreth 16.7 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 82.3 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 800.810 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (143.290 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (14.081 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (13.768 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.338 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Qershor 2018, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 973.289 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 4.985 milionë lekë, po ashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rënie me 15.449 milionë lekë.


Fig-13



Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-14



Përberja e depozitave Qershor 2018

Burimi: Banka e Shqipërisë


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Qershor 2018 janë mbledhur rreth 217.035 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 215.336 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 184.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 30.4 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 37% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 145.5 miliardë lekë (ose rreth 95% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 10.9 miliardë lekë (ose rreth 111% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 45.1 miliardë lekë (ose rreth 106% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 13.0 miliardë lekë (ose rreth 92% e planit të periudhës Janar-Qershor 2018).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 184.8 miliardë lekë, 36.5 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 15.3 miliardë



lekë (8%) për shpenzime interesi, 18.5 miliardë lekë (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 479 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 77.3 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 25.9 miliardë lekë (14%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 9.7 miliardë lekë (5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 46% (shpenzime personeli), 37% (shpenzime për interesat), 41% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 23% (subvencione), 47% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 56% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 42% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 34%, ndërsa financimi i huaj është 37% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Qershor 2018 ishin rreth 217.035 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 202.251 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 13.058 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Qershor 2018 (mld Lekë) Revenues during June 2018 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Qershor '18 June '18	Qershor '17 June '17	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.4	12.0	-4.8
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.5	0.6	-5.4
	Akcizat (Excise)	4.1	4.3	-6.1
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.3	2.0	13.0
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.1	2.6	17.8
	Taksat nacionale (National Tax)	2.8	2.6	7.3

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Qershor – 2018

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: June – 2018

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 1.6 milionë lekë gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Qershor 2018, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 37.026 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 34.592 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Qershor 2018, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 34.1 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 31.1 miliardë lekë dhe shpenzimet për buxhetin vendor me rreth 4.1 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	
Janar	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	1.7	1.3	1.5	2.8	1.7	January
Shkurt	1.4	2.4	1.1	0.5	0.8	1.1	1.9	1.0	1.0	0.9	1.9	2.3	0.2	2.2	2.1	February
Mars	0.5	0.4	0.5	0.4	0.3	0.9	1.4	0.8	0.8	0.9	2.2	2.2	0.3	2.1	2.0	March
Prill	-0.6	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	0.5	0.9	0.5	0.5	0.7	1.7	2.3	0.3	1.9	2.1	April
Maj	-1.1	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2	0.2	0.3	0.2	0.1	0.2	1.6	1.8	0.7	2.0	2.1	May
<b>Qershor</b>	-0.7	-1.1	-0.6	-0.4	<b>-0.1</b>	0.1	0.1	0.04	0.0	<b>0.1</b>	1.5	1.4	1.2	2.2	<b>2.4</b>	<b>June</b>
Korrik	-0.6	-0.7	0.05	-0.14		0.0	0.1	0.19	0.0		1.8	1.3	1.9	2.0		July
Gusht	0.1	0.8	0.86	0.41		0.0	0.1	0.20	0.1		2.0	1.9	2.0	1.6		August
Shtator	0.3	0.6	0.40	0.36		0.0	0.2	0.17	0.1		1.5	2.2	1.8	1.6		September
Tetor	0.1	0.01	-0.2	0.0		0.0	0.2	0.13	0.1		1.4	2.1	1.5	1.9		October
Nëntor	-0.2	-0.3	0.1	-0.1		0.0	0.1	0.12	0.1		1.7	2.1	1.9	1.7		November
Dhjetor	0.7	0.6	0.9	1.0		0.1	0.17	0.19	0.2		0.7	2.0	2.2	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2014	2015	2016	2017	2018						Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
					January	February	March	April	May	June	
<i>Mesatarja e periudhës</i>											<i>Average of period</i>
USD	113.64	126.64	128.29	112.56	109.52	107.39	106.43	105.30	107.42	107.77	USD
EURO	140.11	137.65	135.27	133.25	133.57	132.72	131.27	129.28	126.98	125.95	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>											<i>In the end of period</i>
USD	115.23	125.79	128.17	111.10	107.26	108.12	105.80	106.28	107.61	108.13	USD
EURO	140.14	137.28	135.23	132.95	133.44	132.23	130.44	128.74	125.92	125.93	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2014	2015	2016	2017	2018						In percent	
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June		
<b>Norma e depozitave</b>												Deposits rates
12-M	1.51	1.27	0.78	0.80	0.72	0.80	1.03	0.77	0.75	0.79		12-M
6-M	1.16	1.17	0.78	0.56	0.69	0.75	0.55	0.52	0.56	0.67		6-M
3-M	0.83	0.54	0.27	0.29	0.28	0.25	0.27	0.26	0.27	0.29		3-M
1-M	1.47	0.88	0.87	0.82	0.92	0.76	0.93	0.91	0.64	0.72		1-M
<b>Norma e huasë</b>												Lending rates
12-M	7.00	7.47	4.54	6.79	6.65	6.51	6.84	4.14	5.86	5.22		12-M
6-M	8.18	8.35	7.01	8.12	10.14	8.52	8.01	7.71	6.58	8.33		6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>												Securities rates
Bono thesari 1/												Treasury bills 1/
3-M	3.15	-	-	-	1.31	-	-	-	-	-		3-M
6-M	3.16	2.46	2.00	-	-	2.04	-	1.84	1.92	-		6-M
12-M	3.33	2.40	2.92	2.63	2.71	2.62	2.51	2.36	2.26	2.07		12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2018

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>35,391</b>	<b>67,555</b>	<b>105,295</b>	<b>143,156</b>	<b>180,009</b>	<b>217,035</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>92</b>	<b>365</b>	<b>325</b>	<b>670</b>	<b>1,393</b>	<b>1,726</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>33,116</b>	<b>63,182</b>	<b>98,456</b>	<b>134,346</b>	<b>168,104</b>	<b>202,251</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,858</b>	<b>45,099</b>	<b>72,131</b>	<b>96,027</b>	<b>120,885</b>	<b>145,553</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Verën e Shtuar	11,139	21,896	33,614	44,523	56,527	67,963	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,424	3,542	9,674	13,054	15,588	17,931	Profit Tax
3	Akcizat	3,044	6,139	9,572	12,921	16,627	20,746	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,437	6,001	8,533	11,422	14,244	17,415	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,397	6,645	9,338	12,240	15,467	18,538	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	418	877	1,400	1,867	2,431	2,960	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,365</b>	<b>2,262</b>	<b>3,564</b>	<b>6,952</b>	<b>8,816</b>	<b>10,921</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	267	494	820	1,666	2,197	3,075	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	12	20	183	231	258	268	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,087	1,748	2,561	5,055	6,360	7,578	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>8,892</b>	<b>15,821</b>	<b>22,761</b>	<b>31,367</b>	<b>38,403</b>	<b>45,777</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	7,593	13,556	19,505	26,792	32,805	39,109	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,213	2,093	2,977	4,200	5,103	6,020	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,184</b>	<b>4,009</b>	<b>6,514</b>	<b>8,139</b>	<b>10,512</b>	<b>13,058</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		0	900	900	900	900	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,656	2,989	4,209	5,268	6,827	8,623	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>30,028</b>	<b>63,854</b>	<b>100,280</b>	<b>139,869</b>	<b>180,744</b>	<b>215,336</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,464</b>	<b>57,401</b>	<b>89,748</b>	<b>121,547</b>	<b>153,656</b>	<b>184,848</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>6,018</b>	<b>12,232</b>	<b>18,322</b>	<b>24,343</b>	<b>30,372</b>	<b>36,521</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,157	10,263	15,454	20,610	25,783	31,058	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	847	1,667	2,539	3,378	4,244	5,091	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>2,997</b>	<b>5,968</b>	<b>8,488</b>	<b>10,865</b>	<b>13,063</b>	<b>15,384</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,305	4,622	6,521	8,304	10,039	11,852	Domestic
2	Të Huaja	692	1,346	1,967	2,560	3,024	3,532	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,589</b>	<b>3,901</b>	<b>8,079</b>	<b>11,309</b>	<b>15,136</b>	<b>18,522</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subvencionet</b>	<b>73</b>	<b>174</b>	<b>243</b>	<b>327</b>	<b>421</b>	<b>479</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>11,846</b>	<b>24,573</b>	<b>37,632</b>	<b>50,831</b>	<b>64,604</b>	<b>78,233</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	9,218	18,360	27,987	37,602	47,552	57,908	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,628	6,214	9,323	12,907	16,181	19,453	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,935</b>	<b>7,948</b>	<b>12,403</b>	<b>17,554</b>	<b>21,808</b>	<b>25,990</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,006</b>	<b>2,604</b>	<b>4,581</b>	<b>6,319</b>	<b>8,251</b>	<b>9,721</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	26	50	75	102	128	157	Unemployment insurance benefits
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>		0		0	0	0	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>3,564</b>	<b>6,453</b>	<b>10,532</b>	<b>18,322</b>	<b>27,087</b>	<b>30,488</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	0	1,489	4,862	11,626	16,941	18,876	Domestically financing
2	Financimi Huaj	3,564	4,909	5,531	6,507	9,837	11,292	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetuara</b>							<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>5,363</b>	<b>3,702</b>	<b>5,015</b>	<b>3,286</b>	<b>-735</b>	<b>1,699</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>-3,286</b>	<b>735</b>	<b>-1,699</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-8,041</b>	<b>-6,633</b>	<b>-6,671</b>	<b>-198</b>	<b>2,594</b>	<b>1,372</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	29	36	38	39	42	43	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	6,031	7,867	11,676	13,992	14,922	18,441	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,100	-14,536	-18,386	-14,230	-12,371	-17,112	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>-3,088</b>	<b>-1,859</b>	<b>-3,071</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	3,400	4,351	5,065	6,049	8,834	9,079	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua		87	106	474	944	1,039	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	68	288	146	268	82	1,058	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-791	-1,708	-3,556	-9,404	-10,775	-13,208	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	-	-	-	-	-	-	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2018**

Table of investments 2018

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>8,041</b>	<b>- 6,633</b>	<b>- 6,671</b>	<b>- 198</b>	<b>2,594</b>	<b>1,372</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	149.92	179.16	133.02	6.04	353.09	-80.78	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>- 3,088</b>	<b>1,859</b>	<b>- 3,071</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	-49.92	-79.16	-33.02	93.96	-253.09	180.78	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>-3,286</b>	<b>735</b>	<b>-1,699</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2018  
CUSTOMS REVENUES 2018**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	418	877	1,400	1,867	2,431	2,960	Customs Duties
TVSH	7,665	15,169	24,366	32,880	42,140	50,995	V.A.T
Akcizë	3,044	6,139	9,572	12,921	16,627	20,747	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	234	503	758	1,013	1,275	1,472	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>11,361</b>	<b>22,688</b>	<b>36,097</b>	<b>48,682</b>	<b>62,473</b>	<b>76,175</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2018 (TAX REVENUE )**

TVSH	3,474	6,727	9,247	11,643	14,387	16,967	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,424	3,542	9,674	13,054	15,588	17,931	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,437	6,001	8,533	11,422	14,244	17,415	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,163	6,141	8,580	11,227	14,193	17,066	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>11,497</b>	<b>22,411</b>	<b>36,034</b>	<b>47,345</b>	<b>58,412</b>	<b>69,379</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>22,858</b>	<b>45,099</b>	<b>72,131</b>	<b>96,027</b>	<b>120,885</b>	<b>145,554</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2018

The Deficit and Its Financing for 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>35,391</b>	<b>67,555</b>	<b>105,295</b>	<b>143,156</b>	<b>180,009</b>	<b>217,035</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>30,028</b>	<b>63,854</b>	<b>100,280</b>	<b>139,869</b>	<b>180,744</b>	<b>215,336</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>5,363</b>	<b>3,702</b>	<b>5,015</b>	<b>3,286</b>	<b>-735</b>	<b>1,699</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>-3,286</b>	<b>735</b>	<b>-1,699</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-8,041</b>	<b>-6,633</b>	<b>-6,671</b>	<b>-198</b>	<b>2,594</b>	<b>1,372</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	1,893	3,172	3,126	2,346	2,787	2,782	Treasury bills
b. Obligacione	4,150	4,718	8,585	11,694	12,188	15,723	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-10,196	-9,926	-11,312	-6,249	-6,022	-12,322	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-10,694	-10,576	-12,794	-11,790	-10,028	-12,913	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	499	650	1,482	5,540	4,006	591	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	-549	-830	-835	-843	302	133	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	29	36	38	39	42	43	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-3,361	-3,760	-6,238	-7,137	-6,651	-4,922	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-12	-22	-35	-47	-53	-64	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>-3,088</b>	<b>-1,859</b>	<b>-3,071</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	3,400	4,351	5,065	6,038	8,834	9,079	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	68	288	146	278	82	1,058	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-791	-1,708	-3,556	-9,404	-10,775	-13,208	Repayments
d.Mbeshtetje Buxhetore	0	0	0	0	0	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	3M_I_2017	3M_II_2017	3M_III_2017	3M_IV_2017	3M_I_2018	
<b>Llogaria korente</b>	<b>-1,026.70</b>	<b>-1,303.20</b>	<b>-1,160.50</b>	<b>-1,029.70</b>	<b>-151.60</b>	<b>-236.20</b>	<b>-120.70</b>	<b>-294.60</b>	<b>-164.60</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,729.30</b>	<b>-2,136.60</b>	<b>-2,298.80</b>	<b>-2,602.80</b>	<b>-587.10</b>	<b>-695.30</b>	<b>-753.80</b>	<b>-787.60</b>	<b>-614.50</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	925.30	771.10	713.70	181.30	216.40	183.80	215.70	218.70	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-768.40	-911.70	-937.60	-1,003.30	-833.20	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>8.90</b>	<b>268.40</b>	<b>502.80</b>	<b>796.60</b>	<b>275.40</b>	<b>209.20</b>	<b>380.20</b>	<b>217.40</b>	<b>259.70</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	1,655.00	2,031.50	2,028.20	2,395.70	591.90	677.80	926.30	659.90	621.60	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	1,763.10	1,503.30	1,599.10	316.50	468.60	546.10	442.50	361.90	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-8.40</b>	<b>-159.60</b>	<b>-133.00</b>	<b>-44.10</b>	<b>-8.90</b>	<b>36.40</b>	<b>40.70</b>	<b>22.50</b>	<b>-11.20</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	193.30	110.60	126.00	177.10	79.60	122.90	106.60	96.30	75.80	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-270.20	-259.00	-221.20	-88.50	-86.50	-65.90	-73.80	-87.00	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>702.10</b>	<b>724.60</b>	<b>768.50</b>	<b>820.60</b>	<b>169.00</b>	<b>213.50</b>	<b>212.20</b>	<b>253.10</b>	<b>201.40</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	681.40	851.80	921.50	961.20	198.30	242.20	236.70	284.70	223.00	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	20.70	-127.20	-153.00	-140.60	-29.30	-28.70	-24.50	-31.60	-21.60	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>47.70</b>	<b>86.70</b>	<b>125.70</b>	<b>66.30</b>	<b>23.80</b>	<b>25.30</b>	<b>30.40</b>	<b>42.90</b>	<b>18.30</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>775.60</b>	<b>-956.30</b>	<b>-1,326.20</b>	<b>-712.60</b>	<b>-303.20</b>	<b>-121.90</b>	<b>-253.80</b>	<b>-417.80</b>	<b>-145.90</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	893.10	-801.30	-823.00	-958.40	-202.60	-217.60	-334.00	-218.40	-290.70	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	120.80	-324.80	204.60	-139.00	-21.60	31.20	27.90	2.80	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-275.80	-88.50	181.60	110.10	117.10	48.10	-227.40	141.40	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>315.30</b>	<b>311.00</b>	<b>296.00</b>	<b>298.80</b>	<b>-166.70</b>	<b>13.00</b>	<b>-125.70</b>	<b>49.30</b>	<b>-142.00</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>111.90</b>	<b>50.80</b>	<b>259.50</b>	<b>48.00</b>	<b>8.70</b>	<b>-76.00</b>	<b>37.80</b>	<b>215.40</b>	<b>-142.40</b>	<b>Overall Balance</b>
		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>							
Rezervat	-104.40	97.20	609.60	47.60	8.60	-76.20	37.60	215.40	-142.40	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	46.40	89.90	140.40	71.70	-0.20	-0.90	-0.10	-0.60	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**MJETET VALUTORE NETO**

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2015	2016	2017	2018						Millions of Lek End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	373,917.9	373,896.2	361,943.9	353,261.1	340,573.0	365,283.3	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	401,225.0	400,897.4	388,762.3	381,980.4	365,236.8	390,138.1	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	27,307.1	27,001.2	26,818.4	28,719.4	24,663.8	24,854.8	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	52,048	47,990	48,386	51,449	50,019	35,734	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	3,041	5,588	4,548	3,008	8,679	5,432	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	48,388.1	50,695.0	51,432.9	52,381.3	53,854.1	53,951.2	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	45,347.5	45,107.3	46,884.6	49,372.9	45,175.1	48,519.0	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	46,739.3	39,646.5	28,615.5	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,719.6	1,711.3	1,704.0	1,701.1	1,693.6	1,686.6	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	402,929.6	399,233.0	392,310.1	389,059.3	377,273.8	387,564.9	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	451.8	194.0	146.6	133.9	133.5	127.4	111.5	109.4	110.6	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	50.2	17.5	34.4	73.7	17.3	39.8	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,718	-20,696	-20,668	-20,647	-20,634	-20,736.0	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	43,571.0	43,198.7	38,526.2	36,112.3	33,825.7	34,038.4	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundit i periudhës	2015	2016	2017	2018						Million of Lek End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>546,873</b>	<b>547,602.4</b>	<b>550,280.4</b>	<b>550,796.8</b>	<b>549,941.3</b>	<b>548,184.9</b>	<b>546,089.8</b>	<b>539,542.5</b>	<b>530,192.3</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	<b>887.7</b>	<b>845.5</b>	<b>787.7</b>	<b>776.1</b>	<b>771.5</b>	<b>760.6</b>	<b>751.1</b>	<b>746.6</b>	<b>737.4</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	887.7	845.5	787.7	776.1	771.5	760.6	751.1	746.6	737.4	in Lek
Në valutë	-	-	0.0	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>27,419.7</b>	<b>26,863.9</b>	<b>29,515.4</b>	<b>29,555.4</b>	<b>28,893.7</b>	<b>29,298.0</b>	<b>28,404.6</b>	<b>31,989.6</b>	<b>19,583.9</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	24,456.8	23,869.9	24,439.2	24,406.1	29,474.0	17,051.6	in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	5,098.6	5,023.8	4,858.8	3,998.5	2,515.6	2,532.3	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>355,725.2</b>	<b>343,483.0</b>	<b>334,762.9</b>	<b>334,304.0</b>	<b>334,129.0</b>	<b>331,651.7</b>	<b>329,920.1</b>	<b>319,522.7</b>	<b>320,863.3</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	134,717.3	134,616.4	135,420.6	136,509.2	130,238.4	129,826.4	in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	199,586.7	199,512.6	196,231.1	193,410.9	189,284.3	191,036.9	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>9,537.7</b>	<b>8,687.6</b>	<b>7,944.6</b>	<b>8,028.3</b>	<b>7,866.9</b>	<b>7,940.7</b>	<b>8,049.5</b>	<b>8,085.0</b>	<b>8,552.3</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	3,387.3	3,387.4	3,659.0	3,681.4	3,829.3	4,076.5	in Lek
Në valutë	4,501.5	4,445.3	4,422.3	4,641.0	4,479.5	4,281.7	4,368.1	4,255.7	4,475.8	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>153,303.1</b>	<b>167,722.4</b>	<b>177,269.8</b>	<b>178,133.0</b>	<b>178,280.2</b>	<b>178,533.9</b>	<b>178,964.5</b>	<b>179,198.6</b>	<b>180,455.4</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	108,800.0	109,523.7	110,352.1	111,482.7	112,980.2	114,150.2	in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	69,333.0	68,756.5	68,181.8	67,481.8	66,218.4	66,305.2	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018						Millions of LEK End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>Baza monetare</b>	<b>383,972.8</b>	<b>414,380.9</b>	<b>425,243.1</b>	<b>402,929.6</b>	<b>399,233.0</b>	<b>392,310.1</b>	<b>389,059.3</b>	<b>377,273.8</b>	<b>387,564.9</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	15.3	1.1	1.0	1.0	1.1	1.0	1.0	1.0	1.0	Y/Y change in %
<b>Paraja jashtë korporatave depozituese</b>	<b>239,218.1</b>	<b>249,256.5</b>	<b>265,156.0</b>	<b>257,398.9</b>	<b>257,631.9</b>	<b>254,439.3</b>	<b>252,651.4</b>	<b>254,706.4</b>	<b>256,783.9</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	9.9	4.2	6.4	4.5	5.3	4.0	2.5	3.2	2.5	Y/Y change in %
<b>Depozita</b>	<b>687,292.6</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>740,867.8</b>	<b>737,135.7</b>	<b>728,369.2</b>	<b>726,941.0</b>	<b>721,774.7</b>	<b>726,673.4</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	-29.7	7.3	0.5	0.5	0.9	-12.3	-0.4	-0.8	0.2	Y/Y change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>384,106.9</b>	<b>435,432.3</b>	<b>461,550.1</b>	<b>451,804.2</b>	<b>453,728.7</b>	<b>433,566.2</b>	<b>444,907.8</b>	<b>447,288.8</b>	<b>452,343.9</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	8.7	13.4	6.0	4.9	6.9	4.4	3.9	4.0	4.3	Y/Y change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>723,975.7</b>	<b>736,944.1</b>	<b>738,900.0</b>	<b>725,453.0</b>	<b>725,355.9</b>	<b>715,263.8</b>	<b>714,721.1</b>	<b>713,508.3</b>	<b>716,447.5</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	0.2	1.9	0.3	-0.5	0.4	-0.5	-1.2	-1.3	-1.1	Y/Y change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>1,218,101.2</b>	<b>1,263,453.8</b>	<b>1,266,906.9</b>	<b>1,259,090.4</b>	<b>1,252,787.9</b>	<b>1,238,422.6</b>	<b>1,230,947.9</b>	<b>1,223,010.0</b>	<b>1,230,072.7</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	1.9	3.9	0.3	-0.1	0.4	-0.4	-1.2	-1.5	-0.7	Y/Y change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>										<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	373,917.9	373,896.2	361,943.9	353,261.1	340,573.0	365,283.3	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	63,394.2	65,915.7	59,998.0	52,048.3	47,990.1	48,386.4	51,448.8	50,019.0	35,734.4	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	48,752.0	34,255.6	18,406.7	3,040.7	5,587.7	4,548.0	3,008.4	8,679.0	5,432.2	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	46,739.3	39,646.5	28,615.5	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018						Millions of Leks End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>Në lekë</b>	<b>493,374</b>	<b>487,687</b>	<b>473,744</b>	<b>468,054</b>	<b>467,724</b>	<b>460,825</b>	<b>462,070</b>	<b>458,802</b>	<b>459,664</b>	<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë</b>	<b>153,506</b>	<b>186,176</b>	<b>196,394</b>	<b>194,406</b>	<b>196,097</b>	<b>189,127</b>	<b>192,256</b>	<b>192,582</b>	<b>195,560</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,440.3	1,440.3	1,400.3	1,325.5	1,400.1	1,260.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,540.4	9,176.2	7,985.6	8,119.4	8,339.5	9,285.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,878.0	4,141.0	3,204.0	2,714.6	2,790.5	2,460.5	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,398.4	47,978.6	42,610.3	46,830.4	46,528.5	48,724.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	101,043.0	129,360.4	134,889.0	132,148.4	133,360.6	133,926.8	133,266.5	133,523.8	133,828.8	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>339,869</b>	<b>301,512</b>	<b>277,350</b>	<b>273,649</b>	<b>271,627</b>	<b>271,698</b>	<b>269,813</b>	<b>266,220</b>	<b>264,103.6</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	29.9	18.9	15.2	23.2	23.2	23.2	23.3	23.3	13.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	815.0	976.8	705.2	736.1	737.1	1,651.7	1,497.9	1,505.6	1,499.5	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,714.7	4,877.6	4,695.8	4,622.2	4,502.3	4,997.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,292.1	6,502.2	9,062.4	10,088.0	9,495.0	9,484.8	9,598.1	8,976.8	8,873.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	324,158.3	286,460.2	258,285.1	257,086.5	256,494.3	255,842.0	254,071.9	251,211.5	248,719.5	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>193,918</b>	<b>250,121</b>	<b>267,413</b>	<b>272,814</b>	<b>269,412</b>	<b>267,545</b>	<b>264,871</b>	<b>262,973</b>	<b>267,009.7</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	209.5	366.1	139.8	167.5	184.1	54.9	65.7	83.3	64.5	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,645.4	2,999.4	2,086.3	2,142.9	2,067.7	1,622.1	1,470.2	1,438.7	1,523.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,987.7	3,816.4	3,339.9	3,561.2	3,405.5	3,220.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	53,618.9	73,325.0	74,187.3	77,646.4	75,194.8	76,714.1	74,312.4	74,208.6	74,646.8	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	133,803.4	171,614.8	187,242.7	188,869.3	188,148.8	185,813.7	185,461.7	183,836.7	187,554.3	Other resident sectors
<b>Totali</b>	<b>687,293</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>740,868</b>	<b>737,136</b>	<b>728,369</b>	<b>726,941</b>	<b>721,775</b>	<b>726,673</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,631.0	1,647.6	1,478.4	1,414.5	1,506.7	1,338.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,419.4	11,981.0	11,259.4	11,087.5	11,283.8	12,308.3	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,473.5	11,439.8	15,563.8	12,580.4	12,835.0	11,239.7	10,898.0	10,698.3	10,679.3	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,904.6	125,878.2	132,229.0	137,132.8	132,668.4	128,809.2	130,740.9	129,713.9	132,245.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	559,004.7	587,435.4	580,416.8	578,104.2	578,003.7	575,582.5	572,800.1	568,572.0	570,102.6	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018						Millions of Lek End of period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
<b>AKTIVET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>519,506</b>	<b>514,845</b>	<b>504,853</b>	<b>503,601</b>	<b>481,216</b>	<b>495,278</b>	
<b>Total</b>	<b>126,386</b>	<b>131,887</b>	<b>187,367</b>	<b>175,831</b>	<b>177,397</b>	<b>175,013</b>	<b>177,774</b>	<b>177,750</b>	<b>205,526</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	24,080.7	23,851.6	23,383.7	23,263.9	22,532.6	22,265.0	SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	20.8	24.9	18.8	41.3	30.8	28.2	Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	151,729.1	153,520.5	151,610.0	154,468.4	155,186.6	183,232.9	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>323,679</b>	<b>315,113</b>	<b>259,538</b>	<b>249,916</b>	<b>250,350</b>	<b>241,899</b>	<b>231,121</b>	<b>219,055</b>	<b>216,811</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	201,713.5	199,894.3	190,547.9	178,857.9	165,355.3	163,000.9	nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	48,202.0	50,455.6	51,350.9	52,263.3	53,699.9	53,810.2	central government
<b>Huatë</b>	<b>14,641</b>	<b>31,660</b>	<b>41,591</b>	<b>49,007</b>	<b>42,401</b>	<b>43,838</b>	<b>48,439</b>	<b>41,338</b>	<b>30,301</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	46,739.3	39,646.5	28,615.5	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,718.5	1,710.1	1,703.4	1,699.4	1,691.9	1,685.1	Other resident sectors
<b>Derivatet financiare</b>	<b>27.7</b>	<b>15.8</b>	<b>11.7</b>	<b>9.9</b>	<b>11.1</b>	<b>11.2</b>	<b>8.3</b>	<b>22.2</b>	<b>20.1</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>32,741.6</b>	<b>25,094.1</b>	<b>23,844.9</b>	<b>24,200.3</b>	<b>24,172.7</b>	<b>23,608.1</b>	<b>25,783.5</b>	<b>22,603.4</b>	<b>22,069.2</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>18,882.5</b>	<b>20,961.2</b>	<b>20,574.7</b>	<b>20,543.1</b>	<b>20,513.3</b>	<b>20,484.5</b>	<b>20,475.5</b>	<b>20,447.2</b>	<b>20,551.0</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>519,506</b>	<b>514,845</b>	<b>504,853</b>	<b>503,601</b>	<b>481,216</b>	<b>495,278</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>241,006</b>	<b>262,031</b>	<b>278,611</b>	<b>269,621</b>	<b>269,772</b>	<b>266,520</b>	<b>264,481</b>	<b>265,401</b>	<b>268,402</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	267,722.9	268,004.0	265,964.6	264,149.0	265,333.8	268,278.5	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në parane e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	1,897.8	1,767.8	554.9	332.0	66.9	123.0	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në parane e gjerë</b>	<b>201,586</b>	<b>191,380</b>	<b>200,514</b>	<b>198,054</b>	<b>193,974</b>	<b>192,087</b>	<b>193,325</b>	<b>174,551</b>	<b>185,154</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	19,313.4	19,310.3	19,316.6	19,306.5	17,426.1	17,411.5	Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	45,297.6	45,068.7	46,852.5	49,328.8	45,142.0	48,468.8	Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	133,308.9	129,461.2	125,790.6	124,578.3	111,873.1	119,163.4	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	62.8	62.5	61.9	60.9	60.5	61.6	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	71.0	71.0	65.5	50.6	49.0	49.0	
<b>Huatë</b>	<b>1,810</b>	<b>314</b>	<b>116</b>	<b>95</b>	<b>77</b>	<b>75</b>	<b>56</b>	<b>56</b>	<b>56</b>	-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	95.4	76.5	75.1	56.1	55.7	55.6	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>461.1</b>	<b>1,164.6</b>	<b>463.8</b>	<b>901.8</b>	<b>530.9</b>	<b>491.5</b>	<b>2,514.0</b>	<b>309.4</b>	<b>560.8</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>8,104.4</b>	<b>7,981.2</b>	<b>7,340.5</b>	<b>7,263.5</b>	<b>7,293.5</b>	<b>7,153.6</b>	<b>7,112.5</b>	<b>7,074.3</b>	<b>7,067.3</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>63,391.1</b>	<b>61,859.9</b>	<b>45,882.2</b>	<b>43,571.0</b>	<b>43,198.7</b>	<b>38,526.2</b>	<b>36,112.3</b>	<b>33,825.7</b>	<b>34,038.4</b>	<b>Shares and other equity</b>

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania